



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01.Nr. 16-30571/15
Kaçanik, 29. 09. 2015

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqeverisjen (Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), Lokale lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 shtator, 2015, mori këtë:

VENDIM

Për mbrojtjen e vlers së natyrës të trungjeve të dushkut (Quercus sp) dhe qarrit (quercus cerris) në fshatin Runjevë si monument i natyrës

1. Me këtë Vendim merren nën mbrojtje vlerat e natyrës dy trungje të dushkut (Quercus cerris) dhe një trung të qarrit në fshatin Runjevë - Komuna e Kaçanikut si monumente të natyrës të karakterit botanik (në tekstin e mëtejme Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i natyrës ndodhet në varrezat e fshatit në lagjen Burrniku, në lartësinë mbidetare 506 m, parcela kadastrale numër 00419-0 dhe 00420-0 , Kordinatat:**LAT:** 42.44353, **LONG:** 21.253239 .

1.2. Moshja e trungjeve sillet rreth 250 vjet.

1.3. Njëri nga trungjet nuk është në gjendje të mirë nga se ka filluar tharja e kurorës tij, kurse dy trungjet tjera janë në gjendje të mirë.

1.4. Perimetri i tyre sillet mes. 4-4.50 m, diametri i kurorës është 14-25 m.

2. Monumenti i natyrës spas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/ Natural Landmark –Monument i Natyrës.

2.1. Për monumentin e natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilin përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në monumentin e natyrës ndalohet:

2.1.1. Prerja e trungjeve, thyerja (krasitja) e degëve, mbledhja e gjetheve,

2.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

2.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqës mbrojtur,

2.1.4. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,

2.1.5. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur,

2.1.6. Hapja e varrezave në sipërfaqen e mbrojtur dhe,

2.1.7. Çdo lloj aktiviteti tjetër që mundë të shkaktojë ndryshimin apo dëmtimin e monumentit të natyrës.

2.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

2.2.1. Të gjitha masat e mbrojtëse biologjike-teknike të monumentit të natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit të natyrës.

3. Në zonën buferike të monumentit të natyrës ndalohet:

- 3.1.** Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi mbeturinave dhe mbetjeve tjera ,
- 3.2.** Ndërrimi kulturës,
- 3.3.** Ngjitja e objekteve të cilat kanë ndikim në pengimin e pamjes së monumentit të natyrës.

4. Për zbatimin e masave mbrojtëse të monumentit të natyrës kujdeset Komuna e Kaçanikut.

4.1. Komuna është e detyruar :

4.1.1. Monumentin e natyrës ta mbrojë dhe ta mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara mbrojtëse,

4.1.2. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose ti dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tyre, menjëherë duhet ta lajmërojë Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

4.1.3. Të bëjë shenimin e kufinjëve të monumentit të natyrës në pajtim me Rregulloren për Shenjimin e Zonave të Mbrojtura.

5. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, baza ekonomike-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e monumentit të natyrës.

6. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
3. Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike,
4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi